PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 30.06.2026

Sot në sallën e KB Devoll zhvillohet mbledhja e radhës sipas njoftimit të datës 25.06.2026.
Të pranishëm në sallë: Alfredi Gjata, Valbona Spaho, Oljana Comko, Arsina Mazelliu, Festim Kaso, Oliver Mulla, Genti Dëngolli, Vladimir Kello, Eduard Mano, Trifon Merzaku, Imelda Çuçka.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1 "Miratimi i rendit të ditës".

Hapet votimi: 10 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Ka ndonjë nga këshilltarët konflikt interesi?

Hapet votimi: 0 pro, 11 kundër.

Asnjë nga këshilltarët nuk ka konflikt interesi.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2, "Miratimi i procesverbalit të datës 29.05.2026".

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3. PV 47 datë 21.05.2026. "Për dhënien me qira të sipërfaqes 50 HA në ngastrën me kod kadastral KO0200019 në ekonominë kullosore "Bilisht" (Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme.)"

Oliver Mulla: Unë nuk isha dakord me çmimin por u sqarova. Gjithsesi salepi nuk bëhet aty.

Eduard Duro: Këto pjesë ja lëmë atyre.

Vladimir Kello: Unë herën e parë kërkova të paraqitet plani i biznesit, të shkruhen llojet e bimëve që do kultivohen, teknologjia që do përdoret dhe ndikimin në mjedis.

Eduard Duro: Plani ju është dërguar në email, gjithashtu e keni edhe fizikisht.

Hapet votimi: 9 pro, 2 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4. PV 48 datë 22.06.2026 " Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok ndihmën ekonomike për muajin Maj 2026.
Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5. PV 49 datë 22.06.2026 " Për një shtesë në vendimin e këshillit bashkiak nr.12 datë 26.01.2023"Për miratimin e shtesës në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të kalohen në pronësi të bashkisë Devoll të pasurive kadastrale me numër : 695, Nr.696, Nr.702, Nr.704, Nr.705, Nr.706, Nr. 707, Nr.736, Nr.737 ZK. 1202 Fshati Bitinckë."

Eduard Duro: Nga toka shtet do kalojmë në tokë Bashkie.

Hapet votimi: 10 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 6. PV nr. 50 datë 22.06.2026 "Për një shtesë në vendimin e këshillit bashkiak nr.48 datë 31.07.2023"Për miratimin e shtesës në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore

që kërkohet të kalohen në pronësi të bashkisë Devoll të pasurive kadastrale me numër: 697, Nr.700 ZK. 1202 fshati Bitinckë."

Nuk ka diskutime.

Hapet votimi: 10 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 7. PV nr. 51 datë 22.06.2026 "Për miratimin e listës përfundimtare të familjeve përfituese si dhe të bashkëfinancimit nga Bashkia Devoll, për zbatimin e programit të strehimit social 'Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara."
Eduard Duro: Listën e miratuar të muajit Janar ,Nga Ministria e Ekonomisë janë hequr 3 emra.
Si vjet pati një risi ku Ministria përgjysmoi fondin e vet.Fondi nga Ministria është 35 milion. Financimin nga ana e Bashkisë do ta ndajmë në 2 vite. Për të mos përjashtuar aplikuesit e tjerë, vitin tjetër do të pakësojmë numrin e familjeve përfituese.
Genti Demçolli: Ky projekt që është i përvitshëm është detyrim apo zgjedhje?
Eduard Duro: Jo nuk është detyrim.
Genti Demçolli: Pra këtë e quani sukses? Ka goxha interes, goxha informacion për pjesën m2, po të kishte të njëjtin vullnet për të bërë disa investime publike, sepse dora e Bashkisë nuk ndihet askund. Dhe këto 374 milion lekë të vjetra nqs do të përllogariteshin në të tjera gjëra, në qytet se fshati është harruar, për parqe, stacione, tregje, blerje makinerish. Pra nëse me një buxhet të caktuar Bashkia fillon të pajisë flotën e vet të makinerive, vjen dita që mos të shtrijmë dorën as për pastrimin e mbeturinave as për pastrimin e borës.

Vazhdon diskutimi mes kryetarit Eduard Duro dhe këshilltarit Genti Demçolli.

Hapet votimi: 9 pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me PV nr. 52, datë 24.06.2026 "Për miratimin e venddepozitimit të përkohshëm të mbetjeve inerte.
Eduard Duro: I perkohshem sepse me vend qendrim te përhershëm kanë nevojë për leje mjedisore dhe kanë disa kushte specifike. Do te jete nje stacion transferimi i perkohshem i ketyre mbetjeve inerte, që kryejne banorët e bashkisë. Që mos i hedhin vend e pa vend anës se rrugeve apo anes se nepër urat apo ne toke.
Olive Mulla:Duhet filluar me pastrimin nga "Gurët e zinj e shumë vënde të tjera .
Eduar Duro: Edhe për lejet e autorizimit të cative do të ndryshojë vendini . Do të rritet tarifa e lejës së cative dhe transporti e inerteve do ta bëjmë me mjetet e Bashkisë për ti cuar tek vendi për mbetjet.
Festim Kaso: Materialet qeramike propozoj të merren si materiale dhe të përdoren për rregullime rrugësh.
Eduard Duro : Po e kemi menduar.
Hapet votimi : 11 Pro , o kundër , 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me PV 53 datë 24.06.2026 " Per miratimin e projektit te pare te Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029."
Aurela Furxhi: Për programin buxhetor afatmesëm , janë kryer të gjitha veprimet në sistemin tonë, për ndarjen e të ardhurave të cilat janë miratuar. Të ardhurat e krahasuar me vitin 2025, nga 2026 në vitin 2025 ka një rritje prej 95 milionë lekësh. 2026, krahasuar me vitin 2027, ka një ulje prej 26 milionë lekësh, dhe 2026, krahasuar me rishikimin e buxhetit të 2027 me 2027, ka një ulje prej 21. 7 milionë lekësh, dhe viti 2026, krahasuar me vitin 2028, ka një ulje prej 13 milionë lekësh. Pjesa më e madhe që ka ndikim në lëvizjet e tyre është të taksave ndikimi në infrastrukturë. Po, pikërisht për të referuar vitin 2026 me 3 vite në vazhdim ka një ulje. Tarifë tjetër që ndikon në uljen e planit të të ardhurave është tarifa për mbajtje rrugë rurale, që është një tarifë e përkohshme. Tarifa e përkohshme mund të vendoset njëherë dhe

në dy vite, por në KBA kjo është e parashikuar vetëm për vitin 2026. Për transferta të bashkëshortëzuara kemi një rritje në çdo ditë nga 5%. Për transferta specifike për rritjen e pagës nuk ka ndryshuar, pra asnjë rritje. Dhe transferta specifike kanë të njëjtat nivele gjatë periudhës 2027-2029, ndërsa për vitin 2026 ka një rritje prej 3%. Shpenzimeve për paga dhe sigurimet shoqërore kanë një rritje; 2025, krahasuar me vitin 2026, ka një rritje prej 103 milionë lekësh, ose 31. 9%. Dhe për periudhën 2027-2029 planifikohet po i njëjti nivel shpenzimesh si viti 2026. Shpenzime koherente për, krahasuar nga 2020, referohem 2025 sepse është një vit faktik, prandaj i referohem 2025, ndërsa 2026 ende nuk është mbyllur. 2025, krahasuar me vitin 2026, ka një rritje për shpenzime koherente 41. 7% me buxhetin e rishikuar, për shkak kjo të fondeve që transferohen dhe s'ka përdorur nga viti i kaluar. Por krahasuar dhe me 2026, krahasuar me vitin 2027 janë ulur për shkak të nivelit të rritjes së investimeve. Domethënë, shpenzimet operative janë ulur duke rritur nivelin e investimeve. Transfertat sportive nuk kanë ndryshuar, është në të njëjtat nivele. Përjashtimisht këtë vit ne kemi propozuar me projektvendimin 55, një rritje prej 5 milionë lekësh. Transferta në buxhetet familjare, që përfshijnë ndihmat ekonomike dhe bonusin i qirasë, ka një rritje nga viti 2025 në vitin 2026 prej 2 milionë lekësh, dhe këtu më tepër rritet ndihma ekonomike, ndërsa për periudhën 2027-2029 kemi të njëjtin nivel shpenzimesh. Investimet në vitin 2025, të krahasuar me vitin 2026 që jemi aktualisht, kanë një rritje prej 65. 8%. Niveli i 2026 nuk ndryshon nga vitet e tjera për periudhën 2027-2029, por ka rritje dhe luhatje në bazë të projekteve që ne kemi parashikuar në tabelën përkatëse. Gjithashtu ne kemi marrë dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave, që në të cilat dy, si rekomandime për t'u përmirësuar, janë analiza e të ardhurave për shkak të disa zërave që kanë luhatje dhe raportimi i numrit. Të tjera, çështje teknike apo problematika, ne i kemi zgjidhur hap pas hapi dhe nuk kemi pasur ndonjë problem. Këto kisha unë që mund të thosha në përgjithësi për projektbuxhetin.

Trifon Meraku:. Ne kjo rubrikë këtu, transfertë për klubin e futbollit, 5 milionë lekë. Kemi miratuar në dhjetor 100 milionë lekë. Ka gjendje lekë nga këto?

Aurela Furxhi: Për këtë projekt vendim?

Trifon Meraku: Aktualisht ke marrë projektbuxhetin e dytë.Po ta pyes për të parë, ka lekë në gjendje për klubin e futbollit?

Aurela Furxhi: Jo, deri në këtë moment transferta është përdorur.

Trifon Meraku: Tani këtu janë shtuar 5 milionë lekë. Për çfarë janë këto?

Aurela Furxhi: Trifon po flet për projektvendimin 55.
Vladimir Kello: Sa % e buxhetit kalojnë për pagat e administratës?
Aurela Furrxhi: Rreth 40–50%.
Vladimir Kello: Për mua është shumë, për sa i përket projekt buxhetit që jeni mbështetur në burimet financiare të disponueshme dhe në strategjinë e zhvillimit të Bashkisë dhe prioriteteve që i jepen Këshillit Bashkiak? Për sa i përket buxhetit të Bashkisë, ne vitet e ardhshme, A është përcaktuar mbi bazën e objektivave të shërbimit publik dhe investimeve apo jo?
Aurela Furxhi: Nëse do ta shikonim vendimin materialin, do të shikoni objektivat për secilin program. Objektivat të zbërthyera në afate kohore, në njësi shpenzuese, në produkte po do rezultojnë; këto janë parashikime për 2027–2029. Unë bëra krahasim lidhur me 2025.

Hapet votimi: 10 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me PV Nr. 54 datë 24.06.2026 "Për miratimin vendor të barazisë gjinore Bashkia Devoll 2026-2028."
Zerina Sinani: Është një PV te cilin e kemi kaluar, por për shkak se nuk ishte dërguar për miratim në prefekturë, na u kërkua ta ri-futim përsëri. Nuk ka asgjë ndryshim në përmbajtje.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me PV Nr. 55 datë 24.06.2026 " Per rishikimin e buxhetit të vitit 2026."

Aurela Furxhi: Ishte e veshtirë të gjeje fondet por Transfertat specifike te papërdorura deri tani në arsim dhe në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm i kemi vënë në funksion për pakësimin e zërave që ishin planifikuar nga te ardhurat. Kemi liruar këto të ardhura për të përdorur fonde për këto investime. E para dhe e dyta është një fond prej 6 milion lekësh e akorduar nga Ministria e Mbrojtjes për emergjencat civile, e cila mund të perdoret për investime. Mbi këto bazohen burimet dhe shpërndarja e disa e zërave që ne kemi parashikuar në këtë vend. Fondi i emergjencave civile do te mbeshtese 4 projekte qé do té jene ne 3 vite financim, që është rregullimi i urës së dëmtuar fshati Arrze, rregullimi i urës së demtuar fshati Cete, punime për sistemin e kanalit sekondar fshati Progër. Kjo është financimi pjeserisht, pasi nje pjesé e materialeve do të financohet me fondet e emergjencave civile përsëri prapë, dhe rregullimi i urës së dëmtuar fshati Qyteze. Këto katër projekte fillojne me fondet që janë akorduar nga emergjencat civile. Pjesa tjeter do te jete nga fondet tona. Nese do keni nje pyetje qe pse disa zëra pakësohen në tabelën e parë dhe shtohen në tabelën e dytë, është për shkak te lirimit te fondeve aë ishin planifikuar nga të ardhurat dhe mbështetja e tyre nga transfertat specifike. Kjo ka ndodhur.
nese keni diçka specifike që mund te
sqarohet, keto janë sipas kerkesave te sektoreve qe jane paraqitur . Edhe mbështetja e përmirësimit të kushteve të banimit që fillon nga 15 milion lekë vitin e parë dhe vazhdon per tre vite financimi.
Trifon Meraku : Referuar pyetjes qe bëra më parë .
Aurela Furxhi: Po, deri tani janë te harxhuara, prandaj kerkohet per vazhdimesinë e këtij viti te 5 milion lekë.
Trifon Meraku: Po, ato 100 milione leke jane miratuar per vit kalendarik.Ne miratuam 20 milion dhe vjet ne qershor dhe , bejne 120. Bashkë me keto 170.
Aurela Furxhi: Jo, jo, 170. Mos u ngaterroni.
Jo, jo. Janë 10 milion lekë në buxhetin fillestar të akorduar dhe 5 milion lekë që rishikohet tani dhe kerkohen.
Trifon Meraku; Nga ku i ke hequr?
Aurela Furxhi: Nga të gjitha zërat që permendëm.
Trifon Meraku: Pse duhet të heqin nga zërat e tjerë?
Aurela Furxhi: Derisa mua më ka erdhur nje kerkesë ku thote që kaq leke eshte
harxhuar per paga, kaq per shpenzime, kaq per materiale, dhe pjesa tjeter nuk mbetet atehere..
Trifon Meraku: Kjo eshte pjesa jote. Pjesa tjeter po po të pyes . Nga 100 milion lekë që janë miratuar në dhjetor, ka lekë per sportin apo jo? Kjo eshte pyetja e parë.
Aurela Furxhi: Nga dhjetori jo.
Trifon Meraku: S'ka. Atehere i ke shtuar 50 milion tani.. Për çfarë janë këto 50 milion? Për çfarë do të perdoret?
Aurela Furxhi: Pagat dhe sherbimet shoqërore dhe materialet.
Trifon Meraku: Edhe njehere, kur behet buxheti në dhjetor dhe thuhet kemi 20 futbolliste, 5 trajnere, 5 analiste, dhe 10 milion leke. Dakord? Tani mbyllet kampionati dhe këto shpenzime janë bërë, janë marrë këto leke. Tani këto 50 milion per çfare jane?
Aurela Furxhi: Për vazhdimësinë.
Trifon Meraku: Si ti dhe kryetari i bashkise shume shpejt do keni një kërkesë per transparencën e klubit të futbollit, sepse eshte bërë një gropë e madhe aty q s'mbushet fare as me leke, as me gjë. Po bej dokumentat gati që t'jua bej me dije. Ka ca rregulla edhe në sport edhe kudo. Nuk mundet që ne japim lekë nga bashkia dhe ti i shpenzon si te duash. Dakord? Se këto janë taksa. Para te tjera jane taksat e qytetareve.

Hapet votimi : 10 pro, 1 kunder , 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me PV Nr.56 Date 24.06.2026 "Për miratimin e bashkëortakërisë nëpërmjet dhurimit të një pjese të kuotës nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ALBEDO Solar SHPK dhe autorizimin e kryetarit të bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes për transferimin e kuotave."

Eduard Duro: Ky eshte nje propozim nga 3 subjekte. Kanë projekt planin e bizneseve të tyre për investime në fushën e energjisë rinovuese, konkretisht ne parqe fotovoltaike. Jo se kane qene te interesuar të bëjnë bashkëpunime me bashkinë, por këtë propozim e kam bërë unë, eshte propozim i bashkisë, pasi ata janë të interesuar per të investuar në parqe fotovoltaike, kurse une i kam bére propozimin qe ne te mos behemi me thjesht perfitues të asaj qerasë të tokës të cilët duam të lëshojmë, por te jemi edhe përfitues të energjisë elektrike të prodhuar nga këto parqe fotovoltaike dhe duke u bere aksionere ne firmat apo bizneset e ketyre personave te cilet jane të interesuar. Dhe ky eshtë edhe objektivi i projektvendimit. Eshtë një, kemi tre Propozime pasi para dy muajsh ne kemi bërë një projektvendim ku kemi cilësuae te tre subjektet te cilet kane qene te interesuar dhe perfitimet ekonomike te bashkise ne rastin se keto realizohen janë shumëfish më të larta sesa qeraja e tokes të cilës mund ta leshonim me qira. Kjo eshtë pak a shumë shpjegimi per kéte 26% kam kerkuar une, sepse në qoftë se do kerkoja me pak se 25%, nuk kemi te drejtën e vendimmarrjes. Ligji per shoqërite tregtare, nëse do të jetë 25% që të kesh të drejtën e vendimmarrjes ne asamblene e ortakeve.Dhe unë propozoj një shifër 26% që të ishim brenda ligjit për shogëritë tregtare në rruget e shitjes.

Vladimir Kello : Mbase nga ana financiare, Keshilli i Finances mund te ndihmoje, por ashtu si e kuptoj unë përsa i perket ketij projektvendimi ku flitet per dhurim te kuotave.
Në bazë të ligjit dhurimi i kuotave ose i pasurive publike nuk eshtë nje veprim i zakonshem dhe nuk mund te behet thjesht me një vendim administrativ.

Genti Demcolli: Une nuk kisha asnje material ne email ne lidhje me kete PV, pjesen e marreveshjes. Kjo shoqëria, ju gjeti apo e gjetët? Dhe e dyta, nuk eshtë që pasqyra, nga informacioni që ke bere, eshte nje shoqeri e krijuar jo me larg se gushti 2025 dhe pasqyra financiare e vitit 2025 eshte thjesht minus 3 milion lekë sigurime shëndetësore shoqerore të administratorit. Perpiluesja e këtij projektvendimi, pergjegjesia e sektorit juridik, shkruan që investimi parashikohet te realizohet per nje periudhe 24 mujore dhe me nje kapital fillestar 31 milion euro. Ku dolën këto 31 milion euro? Sepse mund të dal unë sot dhe të premtoj ma jep se mund te..

Eduard Duro: Edhe bashkia kredi do te marré.

Genti Demcolli: Si u zgjodh kjo shoqëri?Sa e besueshme eshte?

Eduard Duro: U ofrua dhe beri kerkesen.Ne po ia pranojmë. Çfarë besimi? Po eshtë letra besimi. Eshtë kontrata besim.

Genti Demcolli : Une nuk mundem ta miratoj, zotëri. Edhe i këshilloj dhe koleget te jenë te kujdesshëm.

Hapet Votimi : 9 pro, 2 kundër, 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken "**Të Tjera**"

Hapet votimi për pikat :

- Raport per monitorimin e zbatimit te buxhetit te vitit 2026, 4-mujori i parë Janar-Prill 2026.
- Prezantim i Raportit të Performances 2025, Bashkia Devoll.

11 Pro, 0 kunder , 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me Doreheqjen e Keshilltares Znj.Arsina Mazelliu.

Hapet votimi për: 11 pro , 0 kundër , 0 abstenim.

Imelda Cucka: Une nuk e di sa mund të flas per gjëra konkrete. Në Sul e di që ka ardhur skrepi, ne Miras po ashtu duke qenë se do të shkojë në çdo fshat, e ka të pamundur me mjetet që disponojme , 1 apo 2 mjete, sa kemi në dispozicion si bashki . Po të paktën shtoni oraret dhe të vijë në ndihmë çdo qytetari. Pjesa e vaditjes, që të paktën edhe ata të mos ikin me idenë që shikoj se nuk i erdhën në ndihmë në kohë perimeve bujqesore, edhe ne nuk kemi atë produktivitet. Ne të jemi të rregullt si detyrime që i kemi komunitetit.

Alfredi Gjata : Ne bëmë një dëgjim publik ku shumë nga kryepleqtë e ngritën këtë problem, madje unë do të kërkoja të Shikojmë që këtë performancën e të dy drejtorëve të bujqësisë , që të shikojmë si do ta përballojmë këtë situatë edhe për vaditjen.

Eduard Duro: Ne u ndodhëm në një periudhë të vështirë realisht, pasi për një muaj e gjysmë nuk u rinovuan kontratat e blerjes së karburanteve. Një muaj e gjysmë ishim pothuajse të paralizuar. Vetëm punimet e emergjencave. Tani puna ka filluar me ritme të shpejta.

Vladimir Kello: Në bazë të ligjit per nxjerrjen e
bagetive nga qendrat e banuara, qofte nga fshati po aq me shume nga ayteti, une desha t'i drejtohesha me pyetjen kryetarit te bashkise deri ku je me zbatimin e vendimit që mori Këshilli Bashkiak. Dhe aq m ë shumë une nuk e di që është marrë ndonje iniciative nga bashkia për ta realizuar kete dhe i bej nje vërejtje atyre keshilltareve. Nuk eshte nevoja qe t'i transmetojnë ato ç'thotë Vladimir Kello apo dikush tjetër qytetarëve, sepse e kanë online dhe e dëgjojnë deri ne Amerikë, jo në fshatin më të afërt apo më te larget te rrethit te bashkise tone. Per sa i perket zbatimit te vendimeve dhe te ligjeve, ne këtë punë kemi që t'i shërbejmë qytetarve dhe këta qytetarë të rrojnë si njerëz. Aq me shume ne qytet. Kryetar, unë mbledhjen e ardhshme dua që të raportohet në lidhje me vendimin që është marrë. Po unë marr shkak se ka disa muaj ë kam kërkuar për nje rruge, në rruga e Xhaçkave, që të hiqet plehu

Marsel Mulla: Eshte hequr keto dite e kemi mbaruar si pune. Nese vazhdojne prap te bejne te njejten gje do te marrim masa.

Vladimir Kello: Nga ana e Komisionit te posacem parlamentar për reformën administrative territoriale në qytetin e Korçes, perfaqesuesi i shoqerise civile Vladimir Kello, kërkoi që dëgjesa të bëhet ne qender te bashkise tone, ne qytetin e Bilishtit. Më mbrapa u bashkëbisedua me te dy bashkekryetaret, qofte ate te grupit parlamentar të PD-së, qofte të PS-së. Ai i PD-së ishte 100%, deklaruan para te gjithe publikut qe do te vijne.

Mbase edhe zoti Masniku eshte dakort dhe duhet te vijne patjeter sepse e kane detyrim ligjor.

*Keshilltari Vladimir Kello lexon Kerkesen**

Alfredi Gjata: Ate e kemi diskutuar sa here, dhe problemi eshtë që krijojmë ilaritete
ndonjehere të panevojshme, sepse indicie nuk kishim po thamë t'i paraprijme, kemi rene dakord t'i paraprijmë. Edhe ata ta harrojne që Devolli nuk do jete bashki, kaq, sepse nuk mund te ka nje logjike ketu. Dhe ska qene ndonjehere ne plan.

Trifon Meraku: Kam nje pyetje per sa i perket ceremonise te dhenies titull nderi qe miratuam para disa mbledhjesh.

Eduard Duro: Per disa dite do te lajmeroheni per zhvillimin e ceremonise.

Trifon Meraku: Gjithashtu kam nje shqetesim dhe dua te merren masa per sa i perket rregullave qe duhet te vendose policia Bashkiake gjate mbasdites te pakten. Ne pedonalen e qytetit levizin njerez me monopatina te cilet jane rrezik per ne qytetaret me femije te vegjel. Pata nje situate me femijen tim dhe ne momentin qe ju drejtova policise bashkiake pata nje debat, pasi kane nje qasje shume te keqe me mua.

Genti Demcolli: Problem i madh eshte edhe pjesa e pazarit. Ne zona kaq te banuara per mendimin tim eshte pengese. Ai pazar per mua nuk perfaqeson asgje pasi po konkurron bizneset vende pasi shiten gjera te reja, fruta perimet etj etj.

Kur mbyllet eshte katastrofe .

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Protokollues:

Kostandina Babolli

Kr. Keshilli Bashkiak

Alfredi Gjata